



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada -Government
Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas(Gllogoc)
Zyra e Kryetarit



01 Nr 400/01-4462 Dt. 09/09/2024

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika b) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr 03/L-040, nenit 17 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr. 03/L-048, nenit 7 dhe 12 të Rregullores MF – nr. -04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Rregullores me nr 320-10338 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve, Kryetari i Komunës së Drenasit, merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e Thirrjes Publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve dhe personave fizik për fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

I

1.Për implementimin e Thirrjes Publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF – nr – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Rregullores me nr.320-10338 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve.

2.Mbështetja publike për projektet/programet e organizatave joqeveritare dhe personave fizik do të sigurohet nga Buxheti i Komunës së Drenasit – kodi 850.Kodi ekonomik Subvencionet 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85001 dhe kodit funksional – 0820.

II

Mjetet e përmendura në nenin 1 të Vendimit do të shpërndahen në bazë të Thirrjes Publike për financimin e projektit, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

III

1.Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes,sipas nenit II të këtij vendimi, përfshinë:

- 1.Teksti i thirrjes publike
- 2.Udhëzimet për aplikantët
- 3.Formularët e aplikimit

2.Formularët e aplikimit të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 1.Formularin e përshkrimit të programit ose projektit(F1)
- 2.Formularin e buxhetit të programit ose projektit (F2)

3. Formularin e deklarimit të mungesës së financimit të dyfishtë të aktiviteteve nga një burim tjetër (F3)
4. Deklaratën e partneritetit (nëse zbatohet - F4)
5. Formularin e deklarimit të programeve dhe projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike (F5)
6. Deklaratën për aktivitetet e kontraktorit të përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur e programin ose projektin (F6)
7. Formulari për përgaditjen e raportit narrativ për projektin apo programin (F7)
8. Formulari për përgaditjen e raportit financiar të programit apo projektit (F8)
9. Formulari – aplikacioni për projektet për individ/persona fizik

IV

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Drenasit komuna.drenas@rks-gov.net

V

Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të. Komuna e Drenasit do ta themelojë Komisionin vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

Komisioni vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me Rregullen MF-nr.04/2017 për financimin publik të OJQ-ve, Rregullores me nr.320-10338 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve

VI

Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve ose të personave fizik.

Komuna e Drenasit do të njoftojë përfituesin për kohën e nënshkrimit të kontratës.

Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

VII

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci